



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 514 Akti

Nr. 575 Vendimi
Tiranë, më 19.10.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|-----------|
| Pamela Qirko | Kryesuese |
| Suela Zhegu | Relatore |
| Etleda Çiftja | Anëtare |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Dajana Skura, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare znj. Marie Tuma, në datën 17.10.2022, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ina Hoxhaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë (e komanduar).

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5, e nenit 179/ b, të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë (e komanduar), në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Trupi gjykues, i shortuar për të shqyrtuar çështjen, përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Alma Faskaj me cilësinë e kryesueses dhe Etleda Çiftja, anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Alma Faskaj. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Marie Tuma.

3. Komisioni, me vendimin nr. 35, datë 7.9.2022, për shkak të largimit për një kohë të pacaktuar të komisioneres Alma Faskaj, për arsye objektive (shëndetësore), ka vendosur me short zëvendësimin e saj me komisioneren Pamela Qirko, në cilësinë e kryesueses, e cila në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit. Në datën 10.9.2022, subjekti deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarin zëvendësues të trupit gjykues.

4. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të

Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

6. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ina Hoxhaj.

8. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

9. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 4.10.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Ina Hoxhaj dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

11. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Ina Hoxhaj i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit

¹Raporti dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 7.10.2019.

²Raporti nr. *** prot., datë 26.10.2017, i DSIK-së, i deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³Raporti me shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2022, i KLGJ-së.

gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj.

12. Znj. Ina Hoxhaj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 13.10.2022. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 14.10.2022.

14. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 17.10.2022, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

15. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Ina Hoxhaj ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

23. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ina Hoxhaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

24. Subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj është bërë subjekt deklarues në vitin 2014 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratat e interesave private për periudhën

2014 – 2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe edhe deklarata *Vetting*).

25. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; si dhe (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

26. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Ina Hoxhaj në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në datën 24.1.2017, në ILDKPKI, ku subjekti ka deklaruar:

27. Apartament⁴ banimi në përdorim, me sipërfaqe 73 m² + vendparkimi, i ndodhur në Tiranë

Vlera e deklaruar: 30.000 lekë/muaj (qira për apartamentin).
2.000 lekë/muaj (qira për vendin e parkimit).

Zotërimi: 50% subjekti dhe 50% bashkëjetuesi.

Në DPV-në 2016: Subjekti ka deklaruar qiranë e apartamentit + vendparkim, në Tiranë, i marrë me personin që bashkëjeton, në vlerën 30.000 lekë/muaj. Kontrata është lidhur në formë shkresore në datën 15.11.2016. Bashkë me apartamentin është marrë me qira edhe vendi i parkimit për vlerën 2.000 lekë/muaj.

28. Nga hetimi i Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj dhe bashkëjetuesi (aktualisht bashkëshorti)⁵ z. F.K kanë lidhur një kontratë qiraje, datë 15.11.2016, me shtetasen I.M (qiradhënëse), për marrjen me qira të një apartamenti, si dhe një vend parkimi nëntokësor, në Tiranë. Në kontratën e qirasë përcaktohet se apartamenti është i sapo përfunduar dhe i pa mobiluar dhe është marrë në dorëzim nga qiramarrësit në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Pagesa e qirasë se apartamentit është përcaktuar në vlerën 30.000 lekë/muaj dhe vendparkimi në vlerën 2.000 lekë/muaj. Kjo kontratë është lidhur me një afat 3-vjeçar, me të drejtë ripërtëritje heshtazi.

29. Në deklarinimin periodik vjetor (në vijim DPV) të vitit 2016, tek rubrika e “detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar qiranë e këtij

⁴Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë qiraje datë 15.11.2016, me palë qiradhënëse I.M dhe palë qiramarrëse F.K dhe Ina Hoxhaj, për apartamentin dhe vendparkimin nr. **, të ndodhura në adresën “Rr e K”, pall. “P.C”, shk. *, PBJ *, ap. **, kati *, Tiranë. Pagesa e qirasë se apartamentit është 30.000 lekë/muaj dhe vend parkimi në vlerën 2.000 lekë/muaj. Kontrata ka afat 3-vjeçar; kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 11.11.2013, palë porositëse I.M dhe palë sipërmarrëse shoqëria ndërtuese “P.C” sh.p.k., për ndërtimin e apartamentit nr. **, me sip. 96.8 m², apartamenti nr. ** me sip. 73 m², apartamenti nr. ** me sip. 73 m², apartamenti nr. ** me sip. 115.5 m², si dhe 4 vende parkimi nr. **, **, 18 dhe 19, në vlerën totale 282.810 euro, të likuiduara jashtë zyrës noteriale.

⁵Subjekti ka lidhur martesë me z. Florjan Kalaja në datën 24.4.2017.

apartamentit në vlerën 30.000 lekë/muaj, si dhe vendparkimin për vlerën e qirasë 2.000 lekë/muaj.

Gjithashtu, në hapësirën e adresës së vendbanimit, subjekti ka deklaruar adresën: “Rr e K”, pall. “P.C”, shk. *, PBJ *, ap. **, k. **, e cila përkon me adresën e vendndodhjes së apartamentit të marrë me qira.

30. Komisioni hetoi lidhur me origjinën e fitimit të pasurisë nga qiradhënësja

Subjekti ka depozituar në ILDKPKI kontratën e sipërmarrjes⁶ së datës 11.11.2013, ku shtetasja I.M, në cilësinë e porositëses, ka porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “P.C.A” sh.p.k., ndërtimin e katër apartamenteve dhe vendparkimeve të hapura, me çmimin 282.810 euro në total, e likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

Nga kërkimi i kryer në sistemin *multifunksional* të ASHK-së, ka rezultuar se shtetasja I. M ka në pronësi disa pasuri⁷ të paluajtshme, ndër të cilat janë edhe apartamenti dhe garazhi të ndodhura në adresën e banimit të deklaruar nga subjekti.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se apartamenti i marrë me qira është prenotuar nga qiradhënësja në vitin 2013, para se subjekti të emërohej në detyrën e gjyqtarës në vitin 2016.

31. Komisioni hetoi mbi ndonjë konflikt interesi të mundshëm të subjektit me pronaren e apartamentit të dhënë me qira dhe nga informacioni i ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec⁸ rezultoi se kjo shtetase nuk ka pasur çështje gjyqësore të shqyrtuara pranë kësaj gjykate.

Komisioni hetoi mbi konfliktin e interesit të bashkëjetuesit të subjektit, z. F.K, me qiradhënësen, duke administruar dosjen e hetimit të kryer ndaj tij, i cili është, gjithashtu, subjekt rivlerësimi. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁹ ka informuar se nuk rezultojnë vendime apo procese gjyqësore në emër të shtetases I.M.

✓ Nga analizimi i akteve të administruara në dosje nuk u evidentua ndonjë situatë konflikt interesi midis subjektit dhe qiradhënësit.

Shpenzime mobilimi

32. Në kontratën e qirasë, datë 15.11.2016, përcaktohet se apartamenti i marrë me qira nga subjekti dhe bashkëjetuesi i saj është i sapopërfunduar dhe i pamobiluar. Në përgjigje të

⁶Kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 11.11.2013.

⁷(1) Njësi me sip. 120 m² me nr. pas. ***; (2) njësi me sip. 126.8 m² me nr. pas. ***; (3) apartament me sip. 88 m², me nr. pas. ***; (4) apartament me sip. 66.4 m², me nr. pas. ***; (5) apartament me sip. 66.4 m², me nr. pas. ***; (6) apartament me sip.105 m², me nr. pas. ***; (7) garazh me sip. 12.5 m², me nr. pas. ***-G**; (8) garazh me sip. 12.5 m², me nr. pas. ***-G**; (9) garazh me sip. 12.5 m², me nr. pas. ***-G**; (10) garazh me sip. 12.5 m², me nr. pas. ***-G**.

⁸Me shkresën nr. ** prot., datë 2.6.2022.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (e administruar nga dosja e hetimit të bashkëshortit F.K).

pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar në mënyrë të detajuar shpenzimet e kryera për mobilimin e apartamentit.

Në analizën financiare janë pasqyruar vlerat për shpenzime mobilimi sipas deklarimeve të subjektit.

Konstatime të Komisionit lidhur me pasuritë në përdorim

33. Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në përdorim (apartament + vendparkimi), në deklaratën *Vetting*.

34. Llogari bankare¹⁰ (studenti) në BKT (inaktive), me gjendje 0 (zero) lekë deri në datën 24.1.2017

34.1 BKT-ja¹¹ ka konfirmuar llogarinë bankare (studente) në emër të shtetases Ina Hoxhaj, të çelur në datën 12.3.2010.

✓ Nga hetimi i kryer, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga banka.

35. Llogari bankare¹² në “Raiffeisen Bank”, me gjendje 59.979 lekë në datën 30.12.2016

35.1 Si burim krijimi subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga.

35.2 “Raiffeisen Bank”¹³ ka konfirmuar llogarinë bankare të pagës në emër të subjektit Ina Hoxhaj, ku nga lëvizjet e llogarisë, gjendja e llogarisë në fillim të vitit 2017 ka qenë në vlerën 59.979 lekë.

35.3 Nga verifikimi i të dhënave bankare evidentohet se kjo llogari është çelur në vitin 2012 dhe në vitet 2013-2014 është kredituar bursa nga Shkolla e Magjistraturës dhe, më pas, në vazhdimësi janë kredituar pagat e subjektit.

✓ Nga hetimi ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga banka.

36. Në lidhje me shumën 96.000 lekë¹⁴ të depozituar në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” në datën 17.11.2014, me burim dhuratë nga prindërit.

¹⁰Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogari bankare e BKT e lëshuar në datën 23.1.2017, në emër të Ina Hoxhaj në vlerën 0 (zero) lekë. Në këtë llogari janë kryer derdhje nga F.K, S.H dhe S.S.

¹¹Me shkresën nr. *** prot., datë 31.3.2021.

¹²Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogari bankare (page) me nr. *** e lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, në datën 20.1.2017, në emër të Ina Hoxhaj, në të cilën i kreditohet paga, me gjendje në vlerën 59.979 lekë.

¹³Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2021.

¹⁴Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogari bankare nga “Raiffeisen Bank”, e lëshuar në datë 20.1.2017, në emër të znj. Ina Hoxhaj, për periudhën 2012 – 2017, ku në datën 17.11.2014 rezulton derdhje në llogari në vlerën 96.000 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

37. Në deklaratën *Vetting*¹⁵ dhe në deklarinimin para fillimit të detyrës në vitin 2014, subjekti ka deklaruar shumën 96.000 lekë të derdhur në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank”, në datën 17.11.2014, me burim krijimi “dhuratë nga prindërit”. Nga të dhënat e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”¹⁶ evidentohet depozitimi *cash* i shumës 96.000 lekë, në datën 17.11.2014 nga shtetasja Ina Hoxhaj.

38. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar, se: *“Prindërit i kanë dhuruar 700 euro (ose 96.000 lekë), të cilat i ka depozituar në llogarinë e saj bankare me rastin e përfundimit të vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës (për vlerësimin më të lartë në temën e diplomës, në raport me kandidatët e tjerë për magjistratë) dhe dekretimit të përkohshëm gjatë stazhit profesional (viti i tretë i Shkollës së Magjistraturës). Këto të ardhura prindërit i kanë pasur si kursime, ndër vite, nga të ardhurat e përbashkëta familjare, të cilat kanë pasur si burim: të ardhurat e tyre nga puna, pjesërisht të ardhurat e mia nga bursa në cilësinë e kandidatit për magjistrat pranë Shkollës së Magjistraturës (nëntor 2012 - nëntor 2014), të ardhurat nga paga e motrës si e punësuar pranë shoqërisë ‘P.C’ sh.a. (marrëdhënia e punës, e cila ka zgjatur gjatë periudhës dhjetor 2010 – mars 2018, si dhe të ardhurat nga pensioni i gjyshes”.*

39. Komisioni i ka kërkuar¹⁷ subjektit të depozitojë dokumentacion provues mbi të ardhurat e ligjshme të familjarëve të saj, për dhuratën me shumë 96.000 lekë.

Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar¹⁸, ndër të tjera, se në vitin 2012 deri në korrik të vitit 2014 është paguar nga Shkolla e Magjistraturës, me bursë, mesatarisht në vlerën 52.428 lekë/muaj, dhe në periudhën nëntor 2014 - korrik 2015, subjekti deklaroi se ka banuar me prindërit, motrën (e shkëputur në mars 2015) dhe gjyshen, duke kontribuar pjesërisht, sipas nevojave dhe mundësisë në ekonominë e përbashkët familjare, sikurse edhe nëna, gjyshja, babai dhe motra.

Subjekti ka saktësuar se duke qenë se ka mbetur rreth 2 muaj pa pagë (nga fillimi i muajit tetor 2014 – nëntor 2014), për t’i ardhur në ndihmë, me rastin e përfundimit të vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës, prindërit i kanë dhuruar 700 euro (ose 96.000 lekë), të cilat i ka depozituar në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” në datën 17.11.2014. Subjekti ka shpjeguar se këto të ardhura prindërit i kanë pasur si pjesë e kursimeve, ndër vite, nga të ardhurat e përbashkëta familjare.

40. Subjekti ka depozituar dokumentacion¹⁹ përkatës lidhur me të ardhurat familjare si:

¹⁵Në rubrikën “angazhime dhe veprimtari private dhe/ ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”.

¹⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2021.

¹⁷Përmes pyetësorit me e-mail datë 13.7.2022.

¹⁸Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 15.7.2022.

¹⁹Dokumentacion i depozituar nga subjekti, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 15.7.2022; certifikata familjare nr. *** (gjendja familjare më 30.6.2017), e lëshuar në datën 2.12.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë; certifikata familjare nr. *** (gjendja familjare më 31.12.2000), e lëshuar në datën 2.12.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile

- i) të ardhurat e kursyera, ndër vite, nga babai i subjektit L.H²⁰;
- ii) të ardhurat e kursyera, ndër vite, nga puna nga nëna e subjektit S.H për përkujdesje të një fëmije në periudhën tetor 2010 – dhjetor 2014 (subjekti ka depozituar²¹ një deklaratë noteriale të shtetas A.D/ punëdhënëse);
- iii) të ardhurat kursime të subjektit të përfituara nga bursa si kandidate për magjistrat pranë Shkollës së Magjistraturës, nga muaji nëntor 2012– shtator 2014²²;
- iv) të ardhurat nga paga e motrës së subjektit Xh.H, si e punësuar pranë shoqërisë “P. C”, gjatë periudhës dhjetor 2010 – mars 2018²³;
- v) të ardhurat nga pensioni i gjyshes së subjektit M.H, në vlerën rreth 15.000 lekë/muaj²⁴.

Në përgjigje të pyetësorit, subjekti thekson faktin se këto të ardhura janë analizuar më parë nga Komisioni, gjatë procesit të rivlerësimit të bashkëjetuesit, z. F.K²⁵.

Konstatime të Komisionit

41. Nga hetimi i kryer, kjo shumë i është dhuruar subjektit përpara fillimit të detyrës dhe nuk disponohet nga subjekti në momentin e depozitimit të deklaratës *Vetting*. Familjarët e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme, duke filluar nga vitet 1990 – 2014, të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume dhe, si e tillë, është reflektuar në analizën financiare për vitin 2014. Në tabelën përmbledhëse të analizës financiare janë pasqyruar të ardhurat e ligjshme sipas dokumentacionit të administruar në dosje.

DETYRIME FINANCIARE

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar detyrimet financiare si:

Korçë; certifikata familjare nr. *** (gjendja familjare datë 11.5.2015), e lëshuar në datën 2.12.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë; deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.12.2020, e lëshuar nga shtetasit S.H dhe L.H.

²⁰Lidhur me të ardhurat e babait L.H, subjekti ka depozituar: ekstrakt i regjistrimit tregtar i lëshuar nga QKB-ja për shoqërinë “****” sh.p.k., e themeluar në datën 23.10.2008, me administrator shtetasi L.H; vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni me nr. *extra* prot., datë 2.12.2020, i lëshuar nga ISSH-ja Drejtoria Rajonale Korçë në emër të L.H, për periudhën 1975 – 1987; vërtetim për bazën e vlerësuar e punëdhënësit R.K, e cila konfirmon të ardhurat e realizuara nga L.H për periudhën 1.4.2000 – 30.9.2000; vërtetim për bazën e vlerësuar e punëdhënësit Bordi i Kullimit, e cila konfirmon të ardhurat e realizuara nga L.H për periudhën 7.5.2007 – 31.8.2008; vërtetim për bazën e vlerësuar e lëshuar nga ISSH-ja Korçë, me nr. *** prot., e cila konfirmon pagesën e kontributeve të derdhura për L.H për periudhën 2019 – 2020.

²¹Lidhur me të ardhurat e nënës së subjektit S.H, subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.12.2020, e lëshuar nga shtetasja A.D (punëdhënëse) për përkujdesje fëmije 2 vjeç.

²²Subjekti ka depozituar: nxjerrje llogarie (dega Fushë-Krujë) nr. klienti ***, në emër të znj. Ina Hoxhaj, e lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, për periudhën 1.1.2014 – 26.11.2014.

²³Për të ardhurat e motrës Xh.H, subjekti ka depozituar: librezë pune me nr. regjistri themeltar ***, e lëshuar për Xh. H (motra), ku evidentohet punësimi në shoqërinë “P.C”, për periudhën 1.6.2013 – mars 2018; nxjerrje llogarie në emër të znj. Xh.H e lëshuar nga “Union Bank”, për periudhën 1.1.2011 – 31.3.2018.

²⁴Vërtetim nr. *** prot., datë 3.12.2020, i lëshuar nga ISSH-ja Drejtoria Rajonale Korçë, për shtetasen M.H (gjyshja e subjektit).

²⁵Vendimi nr. ***, datë 17.12.2020, i Komisionit për subjektin F.K.

42. **Kredi Bankare**²⁶, e lidhur në datën 25.9.2015, me “Raiffeisen Bank”, për shumën 206.000 lekë, për një periudhë 36-mujore. Detyrimi i pashlyer deri në datën 20.1.2017 është 129.574 lekë.

43. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se afati i kredisë ka filluar nga dita e disbursimit të saj, e realizuar në datën 25.9.2015, me kësht mujor 7.171 lekë/muaj dhe normë interesi 11.86%. Kjo kredi është përdorur për të shlyer tërësisht vlerën 87.000 lekë, si detyrim që buronte nga kontrata e overdraftit, e lidhur me “Raiffeisen Bank”, më 22.12.2014.

44. “Raiffeisen Bank”²⁷ ka konfirmuar kredinë e marrë nga shtetasja Ina Hoxhaj në datën 25.9.2015, në shumën 206.000 lekë dhe të mbyllur më 28.2.2017. Bashkëlidhur shkresës ndodhet dokumentacioni²⁸ përkatës i kredisë.

45. Subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në datën 25.9.2015, si dhe detyrimin e mbetur të pashlyer të kredisë në deklaratimet periodike vjetore të viteve 2015 dhe 2016.

Nga verifikimi i dokumentacionit²⁹ të administruar nga “Raiffeisen Bank”, evidentohet se detyrimi i mbetur i kredisë së disbursuar në datën 25.9.2015 është shlyer plotësisht përmes kredisë së marrë nga subjekti me kontratën e kredisë bankare datë 27.2.2017.

46. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se:

- ✓ Deklarimi i subjektit përputhet me informacionin dhe dokumentacionin e ardhur nga banka.
- ✓ Subjekti ka pasur mundësi financiare për pagimin e kësteve të kredisë.

47. Kartë krediti³⁰ (në lekë) lidhur në datën 23.10.2015 me “Raiffeisen Bank”, me limit 160.000 lekë. Detyrimi deri në datën 16.1.2017 është 153.765 lekë.

²⁶Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë kredie bankare datë 25.9.2015, me kredimarrës Ina Hoxhaj dhe kredidhënës “Raiffeisen Bank” për kredi në vlerën 206.000 lekë, me afat 3-vjeçar; kontratë kredie me kufi (*overdraft*) datë 22.12.2014, në “Raiffeisen Bank”, në emër të shtetasës Ina Hoxhaj, për kredi në vlerën 87.000 lekë; plan amortizimi i kredisë, e lëshuar nga “Raiffeisen Bank” në datën 20.1.2017, me detyrim në shumën 129.574 lekë; nxjerrje llogari bankare (page) datë 20.1.2017, në “Raiffeisen Bank”, në emër të shtetasës Ina Hoxhaj, ku më 25.9.2015 është disbursuar kredia në vlerën 206.000 lekë.

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2021.

²⁸Kontratë kredie bankare datë 25.9.2015; formular për mbyllje llogarie rrjedhëse/kartë debiti/paradhënie bankare datë 25.9.2015; ID në emër të shtetasve Ina Hoxhaj dhe F.K; nxjerrje llogarie (dega Fushë-Krujë), e lëshuar në datën 18.9.2015, nga “Raiffeisen Bank” në emër të shtetasës Ina Hoxhaj (për harkun kohor 1.4.2015 - 18.9.2015).

²⁹Dokumentacioni i dërguar nga “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. ***prot., datë 12.4.2021: kontratë kredie bankare datë 27.2.2017; sigurimi i jetës për kredi për shtetasen Ina Hoxhaj datë 27.2.2017; kërkesë datë 27.2.2017 për shlyerjen e parakohshme të kredisë nga shtetasja Ina Hoxhaj; vërtetim nr. ** prot., datë 15.2.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; certifikatë familjare e lëshuar në datën 23.2.2017 nga Njësia Bashkiake Nr. *, Tiranë; letërnjoftim ID e shtetasës Ina Hoxhaj; certifikatë e sigurimit të jetës e lëshuar në datën 27.2.2017 nga shoqëria “S.U.G.A” në emër të shtetasës Ina Hoxhaj; formular i aplikimit për sigurim datë 27.2.2017 nga shtetasja Ina Hoxhaj.

³⁰Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: marrëveshje mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit *Master Card*, datë 23.10.2015, në “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Ina Hoxhaj me limit në vlerën 160.000 lekë. Fatura e kartës së kreditit nga “Raiffeisen Bank”, në emër të Ina Hoxhaj në vlerën 153.765 lekë në datën 13.12.2016.

47.1 “Raiffeisen Bank”³¹ ka konfirmuar llogarinë për tërheqje *Master Card*, me gjendje – 15.579 lekë (minus) në emër të shtetases Ina Hoxhaj, e çelur në datën 29.10.2015.

47.2 Në DPV-në e viteve 2015 dhe 2016 subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e detyrimit të mbetur të pashlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

48. Kartë krediti³² (në euro) lidhur më 23.10.2015 me “Raiffeisen Bank”, me limit 500 euro.

48.1 Detyrimi i pashlyer deri në datën 16.1.2017 është 381.4 euro.

48.2 “Raiffeisen Bank”³³ ka konfirmuar llogarinë për tërheqje *Master Card* me gjendje - 412.39 euro (minus) në emër të shtetases Ina Hoxhaj, e çelur në datën 29.10.2015.

48.3 Nga verifikimi i deklarimeve periodike në vitet 2015 dhe 2016, subjekti ka deklaruar kartën e kreditit (në euro) dhe gjendjen e detyrimit të mbetur deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

✓ Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me informacionin dhe dokumentacionin e ardhur nga banka. Në analizën financiare janë reflektuar pagesat e interesave në vite për këtë llogari, nga ku duket se subjekti ka pasur mundësi për mbulimin e interesave.

49. Kartë krediti³⁴ në “Tirana Bank” në emër të bashkëjetuesit

49.1 Detyrimi i mbetur është në shumën -87.156 lekë.

49.2 “Tirana Bank”³⁵ ka konfirmuar se z. F.K ka llogari pranë bankës, në monedhën lekë, të çelur në vitin 2012, si dhe kartë krediti me limit 100.000 lekë.

49.3 Sipas të dhënave të llogarisë bankare ka rezultuar se kjo kartë është përdorur kryesisht për blerje.

✓ Deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e ardhur nga banka.

50. Overdraft³⁶ në llogarinë rrjedhëse në “Tirana Bank”, në emër të bashkëjetuesit

³¹Shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2021.

³²Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: marrëveshje mbi përdorimin e kartës individuale të kreditit *Master Card*, datë 23.10.2015, në “Raiffeisen Bank”, në emër të Ina Hoxhaj, me limit në vlerën 500 euro; fatura e kartës së kreditit datë 30.12.2016 nga “Raiffeisen Bank”, në emër të Ina Hoxhaj në vlerën - 381.4 euro.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2021.

³⁴Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë kredie për lëshim kartë krediti visa datë 16.10.2012, e lidhur midis “Tirana Bank” dhe kartëmbajtësit z. F.K, në vlerën 100.000 lekë; faturë mujore datë 16.1.2017 me detyrim të mbetur - 87.156 lekë dhe *e-mail* nga “Tirana Bank”; faturë nga “Tirana Bank” në emër të z. F.K me limit përdorimi në vlerën 100.000 lekë; nxjerrje llogari bankare WinBank, në “Tirana Bank”, datë 14.10.2016.

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

³⁶Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë kredi *overdraft* datë 14.10.2013, e lidhur midis “Tirana Bank” dhe kredimarrësit F.K, në shumën 200.000 lekë; kontratë kredi *overdraft* datë 13.10.2014, e lidhur midis “Tirana Bank” dhe kredimarrësit F.K, në shumën 200.000 lekë; kontratë kredi *overdraft* datë 5.10.2015 e lidhur midis “Tirana Bank” dhe kredimarrësit F.K në shumën 200.000 lekë, shumë e cila do të zvogëlohet çdo muaj me 5.000 lekë. Plan amortizimi, datë 10.5.2015; kontratë kredi *overdraft* datë 17.10.2016 e lidhur midis “Tirana Bank” dhe kredimarrësit F.K në shumën

50.1 Detyrimi i mbetur është në vlerën -100.048 lekë.

50.2 “Tirana Bank”³⁷ ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të z. F.K, të çelur në vitin 2012, ku nga lëvizjet e llogarisë bankare evidentohet se në datën 14.10.2013 z. F.K ka tërhequr nga llogaria e tij shumën 200.700 lekë me përshkrimin “tërheqja e overdraftit”.

✓ Nga hetimi i kryer nuk evidentohen problematika.

51. Apartament banimi në Vlorë, me qira³⁸, në përdorim deri më 14.11.2016. Vlera e qirasë ka qenë 15.000 lekë/muaj.

Faktet e rezultuara nga hetimi i kryer

52. Nga aktet e administruara në dosje rezulton se bashkëjetuesi i subjektit z. F.K ka lidhur një kontratë qiraje në datën 8.3.2015 me qiradhënësin z. I.Ç (i përfaqësuar me prokurë nga av. D.H), për marrjen me qira të një apartamenti (2+1), me sipërfaqe teknike 80.5 m², në katin e tretë, të ndodhur në Vlorë, për një afat kohor të pacaktuar, me qira në vlerën 15.000 lekë/muaj. Sipas deklarimeve të subjektit, kjo kontratë ka përfunduar në datën 14.11.2016.

52.1 Nga verifikimi i deklarimeve periodike në vitet 2015 dhe 2016, në rubrikën e detyrimeve, subjekti ka deklaruar kontratën e qirasë për shtëpinë e banimit në Vlorë, të marrë me qira me bashkëjetuesin.

53. Gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar³⁹ se në korrik të vitit 2015 (pas përfundimit të stazhit profesional të Shkollës së Magjistraturës) ka filluar bashkëjetesën me z. F.K, i cili, gjithashtu, është subjekt rivlerësimi dhe në këtë periudhë ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

54. Lidhur me origjinën e fitimit të kësaj pasurie, në dosje është administruar kontrata e sipërmarrjes⁴⁰ datë 6.3.2010 dhe shtesë kontrate⁴¹ datë 18.10.2010, ku evidentohet se pronarit i apartamentit ka shkëmbyer truallin me apartamente që janë ndërtuar nga shoqëria ndërtuese “D” sh.p.k.

✓ Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan problematika lidhur me këtë pasuri në përdorim.

PASURITË E BASHKËJETUESIT – F.K

145.000 lekë. Plan amortizimi, datë 18.10.2016; nxjerrje llogarie bankare për vitet 2012 – 20.1.2017, me gjendjen e llogarisë së pagës (*overdraft*), në vlerën -100.048 lekë.

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

³⁸Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë qira banese datë 8.3.2015 me palë qiradhënëse I.Ç, përfaqësuar me prokurë nga av. D.H dhe palë qiramarrëse F.K, për apartamentin me sip. 80.5 m², me nr. pasurie ***, me qira mujore 15.000 lekë; certifikatë e regjistrimit të pasurisë në emër të z. I.Ç, lloji truall me sip. 300 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, në Vlorë. Kartelë e pasurisë së paluajtshme. Harta treguese, kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 6.3.2010, e lidhur midis pronarit të truallit I.Ç, përfaqësuar nga av. D.H dhe shoqërisë së ndërtimit “D” sh.p.k., i cili shkëmben truallin me apartamente që do të ndërtohen nga firma ndërtuese. Shtesë kontratë nr. ***, datë 18.10.2010. Planimetri të studimit të pallatit.

³⁹Në përgjigje të pyetësorit standard.

⁴⁰Kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 6.3.2010, e lidhur midis z. I.C dhe shoqërisë “D” sh.p.k.

⁴¹Shtesë kontratë sipërmarrje nr.***, datë 18.10.2010.

55. Automjet tip “BMW”⁴², viti i prodhimit shtator 2005, blerë më 18.3.2015

Vlera e deklaruar: 5.600 euro.
Zotërimi në përqindje: 100%.
Burimi i krijimit: nuk ka deklaruar burim krijimi të kësaj pasurie.

Hetimi i kryer nga Komisioni

56. DPSHTRR-ja⁴³ ka konfirmuar automjetin e regjistruar në pronësi të z. F.K, me targa AA *** KL. Bashkëlidhur shkresës ndodhet dosja përkatëse e automjetit, ku dokumentohet blerja e tij me kontratë shitblerjeje datë 18.3.2015.

57. Nga verifikimi i dosjes⁴⁴ së automjetit ka rezultuar se z. F.K ka blerë automjetin tip “BMW”, me vit prodhimi 2005, përmes kontratës së shitblerjes⁴⁵ datë 18.3.2015 me shitës A.Xh (i përfaqësuar me prokurë nga z. F.Xh), në vlerën 5.600 euro, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

58. Në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se detyrimi është shlyer ditën e nënshkrimit të kontratës. Nga aktet në dosje evidentohet se ky mjet është blerë nga shtetasi A.Xh në Itali, ku në dokumentin doganor të datës 28.10.2014 pasqyrohet se çmimi i blerjes së automjetit në shtetin italian është llogaritur në vlerën 250.000 lekë dhe rezulton që është paguar taksa doganore në shumën 163.096 lekë nga shtetasi A.Xh.

✓ Nga verifikimi i akteve nuk u evidentuan problematika.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

⁴²Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targa AA *** KL, në emër të F.K. Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor në gjuhën italiane në emër të shitësit A.Xh; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.3.2015, me palë shitëse A.Xh dhe palë blerëse F.K, të mjetit me targa AA *** KL, në vlerën 5.600 euro.

⁴³Shkresë nr. *** prot., datë 1.4.2021.

⁴⁴Dosja e mjetit me targa AA *** KL dërguar nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2021 si në vijim: e-mail me subjekt “Kërkesë tepër urgjente”, i vulosur nga Drejtoria Rajonale Vlorë me nr. *** prot., datë 5.8.2020; e-mail me subjekt “Kërkesë urgjente” e vulosur nga Drejtoria Rajonale Vlorë me nr. *** prot., datë 24.7.2020; shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2017, drejtuar Drejtorisë Rajonale Vlorë; leja e qarkullimit rrugor dhe të dhënat lidhur me të datë 26.3.2015, në emër të F.K; ID e shtetasit F.K; certifikata e kontrollit fizik, e lëshuar në datën 26.3.2015, për mjetin me targa AA *** KL, në emër të F.K; pamje fotografike të mjetit me targa AA *** KL; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.3.2015; prokurë e posaçme me nr. repertori *** dhe vulë apostile të lëshuar në datën 3.3.2015 dhe përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetimin e noteres I.B me nr. *** rep., datë 18.3.2015; rezultatet e kërkimit në RBS datë 17.3.2015; certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targa AA *** KL në emër të A.Xh; leje qarkullimi nr. VLD***, për mjetin me targa AA *** KL; leje e qarkullimit rrugor dhe të dhënat lidhur me të, e lëshuar në datën 5.11.2014, në emër të A.Xh; certifikatë e kontrollit fizik e lëshuar në datën 4.11.2014, në emër të A.Xh; pamje fotografike e mjetit; faturë zhdoganimi datë 28.10.2014; urdhërçlirimi e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; leje qarkullimi për mjetin me targa italiane, e përkthyer me vërtetim përkthimi nr. ** rep., datë 4.11.2014 nga noteri V.M; policë sigurimi datë 5.11.2014 e lëshuar nga ***-u për mjetin me targa AA *** KL, në emër të A.Xh; fatura tatimore të datave 4.11.2014, 5.11.2014 dhe 26.3.2015.

⁴⁵Kontratë shitblerjeje autoveture nr.***, datë 18.3.2015.

59. Në deklarin periodik të vitit 2014, z. F.K, si subjekt rivlerësimi, ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit: (a) kredinë *overdraft* në vlerën 200.000 lekë; (b) të ardhura nga shitja e librit 200.000 lekë; si dhe (c) pjesa tjetër kursime nga paga dhe puna si pedagog.

59.1 Pavarësisht faktit se automjeti është blerë nga z. F.K para se të fillonte bashkëjetesën me subjektin e rivlerësimit Ina Hoxhaj në korrik të vitit 2015, Komisioni ka analizuar burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie si vijon:

a) Kredia *overdraft*, marrë në “Tirana Bank”, me limit në vlerën 200.000 lekë

Nga verifikimi i të dhënave bankare të dërguara nga “Tirana Bank”⁴⁶ evidentohet se në datën 14.10.2013 z. F.K ka tërhequr nga llogaria bankare shumën 207.000 me përshkrimin “tërheqja e *overdraftit*”, ku gjendja e llogarisë në datën 31.12.2013 rezulton të jetë - 129.853.9 lekë, ndërsa në datën 31.12.2014 në shumën -180.718.35 lekë.

Ndërsa, gjatë harkut kohor 1.1.2015 - 18.3.2015, kur është blerë automjeti, në këtë llogari janë kredituar: (i) pagat e z. F.K si gjyqtar në shumën 264.743 lekë; (ii) shuma prej 6.800 lekësh si honorar nga revista “A”; si dhe (iii) janë depozituar *cash* në dy transaksione shuma prej 84.000 lekësh duke rezultuar në datën 18.3.2015 me një gjendje në llogari në shumën 80.097.08 lekë.

Në datën 19.3.2015 (një ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes datë 18.3.2015) bashkëjetuesi z. F.K ka tërhequr nga llogaria bankare shumën 119.700 lekë, duke përdorur në këtë mënyrë limitin total të *overdraftit* dhe duke e çuar llogarinë në gjendjen -199.922.08 lekë. Si burim për këtë shumë të tërhequr kanë shërbyer kryesisht të ardhurat nga pagat, të cilat do të trajtohen në vijim (pika c).

Kjo shumë është tërhequr pas datës 18.3.2015, datë në të cilën sipas deklaramit të bashkëjetuesit në deklaratën *Vetting* është bërë likuidimi i mjetit.

b) Të ardhura nga shitja e librit 200.000 lekë

Në deklaratën *Vetting*, tek rubrika e të ardhurave, bashkëjetuesi i subjektit, z. F.K, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar: “*Të ardhura nga shitja e librave ‘Gjykimi në mungesë në procesin civil’ dhe ‘Dilema Kushtetuese I’, ku shitjet janë kryer ose gjatë promovimeve, ose nga shtëpia botuese, ose librat e ndryshëm në Tiranë dhe Vlorë nga vitet 2014 – 2016, ku 30 % deri në 40 % e shumës mbahet nga shitësi + tatimet. Afërsisht nga shitjet dhe fakti sa libra janë stok, të ardhurat kapin vlerën 600.000 lekë*”.

Lidhur me këto të ardhura subjekti ka depozituar dokumentacionin vijues:

- vërtetimin e datës 24.10.2016, ku shtëpia botuese “F.N” konfirmon botimin e librave “Gjykimi në mungesë në procesin civil” dhe “Dilema Kushtetuese I” .

⁴⁶Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

- dokumentacionin provues⁴⁷ për përfitimin e të ardhurave nga shitja e këtyre botimeve disa fatura tatimore shitje, ku provohen të ardhurat e përfituara nga shtëpia botuese në shumën totale prej 104.800 lekësh për vitin 2016. Faturë shitje e datës 25.2.2016 me palë shitëse F.K dhe palë blerëse “A. ***” të librit “Gjykimi në mungesë në procesin civil” në sasinë 8 copë në vlerën 10.400 lekë, me të cilën provohen të ardhurat e përfituara në shumën 10.400 lekë. Nga dokumentacioni i administruar nuk provohet pagesa e tatimit për fitimin e realizuar, për këtë arsye nuk janë reflektuar në analizë financiare.

c) Kursime nga paga si gjyqtar dhe pedagog

Nga verifikimi i të dhënave të llogarisë bankare të pagës në “Tirana Bank”⁴⁸ rezulton se nga data 1.1.2015 deri në datën e blerjes së automjetit 18.3.2015, z. F.K ka përfituar paga në shumën 264.743 lekë, si dhe të ardhura nga puna si pedagog në shumën 98.100 lekë, shumë e transferuar në llogarinë e tij bankare në BKT⁴⁹ nga universiteti “Pavarësia”, Vlorë, në datën 9.3.2015 dhe tërhequr nga z. F.K në datën 10.3.2015.

Analiza financiare

60. Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësitë për blerjen e automjetit në datën 18.3.2015, duke marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës, reflektuar në tabelën vijuese.

| | Përshkrim | Vlera në lekë |
|----------|--|-----------------|
| A | Të ardhurat | 188,994 |
| 1 | Likuiditete (<i>cash</i> + bankë) 1.1.2015 | -180,649 |
| 2 | Të ardhura nga paga e subjektit 1.1.2015 - 18.3.2015 ⁵⁰ | 369,643 |
| | | |
| B | Pasuri | 704,003 |
| 1 | Automjet tip “BMW”, blerë më 18.3.2015 | 784,000 |
| | Likuiditete (<i>cash</i> + bankë) më 18.3.2015 | -79,997 |
| C | Shpenzime | 75,189 |
| 1 | Shpenzime jetike 1.1.2015 - 18.3.2015 | 46,724 |
| 2 | Shpenzime <i>TIMS</i> | 13,765 |
| 3 | Shpenzime qiraje | 14,700 |
| | | |
| | Mundësia financiare në momentin e blerjes së mjetit (A-B-C) | -590,198 |

⁴⁷Faturat tatimore të shitjes me shitës R.H si përfaqësues i shtëpisë botuese “F.N”: (i) faturë tatimore shitje nr. **, datë 26.2.2016, në vlerën 21.000 lekë, sasia 15 copë; (ii) faturë tatimore shitje nr. **, datë 26.2.2016, në vlerën 42.000 lekë, sasia 30 copë; (iii) faturë tatimore shitje nr. **, datë 26.2.2016, në vlerën 32.000 lekë, sasia 20 copë; (iv) faturë tatimore shitje nr. **, datë 7.3.2016, në vlerën 9.800 lekë, sasia 7 copë.

⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datë 7.4.2021.

⁴⁹Shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2021.

⁵⁰Kjo vlerë është rezultat i shumatores së pagave në “Raiffeisen Bank” prej 264.743 lekësh, shumës prej 6.800 lekësh të përfituar nga shkrimi në revistën “A” dhe 98.100 lekë të përfituar nga puna si pedagog dhe të tërhequra në BKT.

61. Nga analiza e kryer nga Komisioni ka rezultuar se bashkëjetuesi F.K ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 590.198 lekë, për blerjen e këtij automjeti në datën 18.3.2015.

62. Në lidhje me këtë balancë negative, Komisioni i ngarkoi subjektin barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, përmes prapësimeve të depozituara në datën 13.10.2022, pretendon se në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë edhe të ardhurat e saj për këtë investim. Subjekti është shprehur se bashkëjetuesi F.K (aktualisht bashkëshorti i saj) ka qenë njëkohësisht subjekt rivlerësimi dhe i është nënshtruar procedurës së rivlerësimit nga Komisioni, i cili me vendimin e formës së prerë nr. ***, datë 17.12.2020, ka vendosur konfirmimin e tij në detyrë.

Sipas subjektit, një nga çështjet për të cilën bashkëjetuesit të saj iu ngarkua barra e provës nga Komisioni, ka qenë edhe justifikimi i burimit të krijimit të shumës për blerjen e automjetit, në vlerën 590.198 lekë për të cilën z. F.K ka dhënë shpjegimet e tij, ku, ndër të tjera, ka pretenduar se nga burimet e të ardhurave të tij gjatë vitit 2014 dhe fillimit të vitit 2015, për blerjen e automjetit, kanë qenë edhe të ardhurat e të fejuarës Ina Hoxhaj, e cila nga muaji nëntor 2014 ishte emëruar përkohësisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti ka argumentuar se analizimi i burimeve të ligjshme për këtë pasuri përbën gjë të gjykuar për subjektin e rivlerësimit z. F.K, duke depozituar kopje të vendimit nr. ***/2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke pretenduar që ky akt të bëhet pjesë e fashikullit të gjykimit në cilësinë e provës dhe, njëkohësisht, të merret në konsideratë nga Komisioni gjatë vendimmarrjes.

Vlerësimi i Komisionit

63. Trupi gjykues, paraprakisht, vlerëson të argumentojë mbi aspektin procedural lidhur me pretendimin për automjetin e blerë nga bashkëjetuesi duhet konsideruar gjë e gjykuar. Trupi gjykues vlerëson se nuk është përpara zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*), duke arsyetuar se:

63.1 Referuar ligjit nr. 76/2016 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, parashikon se: “3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio* ... 5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese ...6. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë të pavarur dhe të paanshëm”.

63.2 Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, procesi i rivlerësimit të bashkëjetuesit të subjektit është kryer nga një trup gjykues i pavarur i Komisionit dhe, po ashtu, nga një trup tjetër i shortuar dhe i pavarur për subjektin Ina Hoxhaj. Në këtë kontekst, për kryerjen e këtij procesi rivlerësimi ndaj çdo subjekti, ligjvënësi ka parashikuar dispozitat⁵¹ përkatëse ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, të cilat veprojnë individualisht ndaj secilit prej subjekteve të rivlerësimit.

64. Vendimi nr. ***, datë 17.12.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përket z. K dhe subjekti i rivlerësimit është bërë pjesë e këtij procesi me statusin e personit të lidhur, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Në funksion të një shqyrtimi në tërësi të kësaj çështjeje, trupi gjykues çmon se ky vendim i Komisionit nuk duhet të afektojë drejtësinë dhe objektivitetin e procesit të rivlerësimit, për një hetim të pavarur, të paanshëm për çdo subjekt rivlerësimi.

65. Në përfundim, duke marrë në konsideratë konstatimin e arsytuar sa më sipër, trupi gjykues ka konkluduar se nuk u provuan plotësisht të ardhurat e ligjshme për blerjen e këtij automjeti, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues çmon se balanca negative e rezultuar nga analiza është në një masë të tillë që, nuk mund të përbëjë shkak për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

66. Shtëpi e prindërve në F- K, në përdorim

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje⁵² evidentohet se kjo pasuri është përfituar nga prindërit e tij, nga privatizimi i banesave shtetërore në datën 10.10.1993.

✓ Nga verifikimi i akteve nuk u evidentuan problematika.

67. Llogari në “Raiffeisen Bank”, “ProCredit Bank”, “Credins Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank” dhe BKT. Zotëron: 100%.

Institucionet bankare kanë dërguar informacione dhe të dhëna si vijon:

68. “Raiffeisen Bank”⁵³ ka konfirmuar se shtetasi F.K ka qenë klient i bankës, por aktualisht këto llogari bankare janë mbyllur. Referuar pasqyrave të llogarive bankare evidentohet se z. F.K ka pasur një llogari rrjedhëse në lekë, në të cilën ka kryer veprime në vitet 2007 – 2008, si dhe një llogari page. Të dyja llogaritë bankare janë mbyllur në datën 15.7.2016.

69. “ProCredit Bank”⁵⁴ ka informuar se z. F.K ka pasur një llogari kursimi të hapur në datën 13.4.2007 dhe në këtë llogari nuk janë kryer transaksione, deri në momentin e mbylljes së saj më 31.7.2008. Gjithashtu, z. F.K ka pasur edhe një llogari rrjedhëse,

⁵¹Neni 49 - mjetet për kërkimin e provës 1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka të drejtë: (a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të pikës 2, të nenit 3, të këtij ligji; (b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit.

⁵²Dokumentacioni i pronës i përcjellë nga ASHK Drejtoria Vendore Krujë me shkresën nr. *** prot., datë 16.9.2020.

⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2021.

⁵⁴Shkresë nr. OP-*** prot., datë 25.3.2021.

aktualisht, të mbyllur ku janë kryer transaksione vetëm në vitet 2007 dhe 2008. Llogaria është mbyllur në datën 10.4.2011.

70. “Credins Bank”⁵⁵ ka informuar se z. F.K është klient i bankës. Bashkëlidhur shkresës ndodhet printimi i llogarisë së pagës, në të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka kaluar pagat për periudhën 1.11.2010 – 4.1.2012. Kjo llogari është mbyllur në 31.3.2015.

71. “Intesa Sanpaolo Bank”⁵⁶ ka informuar se z. F.K ka pasur llogari pranë kësaj banke. Bashkëlidhur shkresës ndodhet kopje e statementit bankar (gjendje e llogarisë), ku në këtë llogari evidentohet se në vitin 2008 kanë kaluar pagat nga Ministria e Drejtësisë dhe llogaria është mbyllur në datën 3.11.2009.

72. BKT-ja⁵⁷ ka konfirmuar një llogari page në lekë në emër të shtetasit F.K të hapur në datën 20.11.2013 dhe një llogari rrjedhëse në monedhën euro të hapur në datën 25.4.2017. Bashkëlidhur shkresës ndodhen pasqyrat e llogarive bankare ku në llogarinë e pagës në lekë janë kredituar kryesisht pagat nga universiteti “P”, Vlorë dhe gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 është 0 lekë, ndërsa në llogarinë në monedhën euro kanë kaluar pagesat e përfituara prej tij si trajnues dhe ekspert në projekte të ndryshme.

✓ Nga hetimi i kryer ka rezultuar se llogaritë në bankat respektive janë deklaruar saktë dhe nga analizimi i të dhënave bankare nuk rezultuan problematika.

VERIFIKIMET TË TJERA TË KRYERA NGA KOMISIONI

73. Komisioni hetoi lidhur me banesat në përdorim, të deklaruara nga subjekti ndër vite.

74. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar në mënyrë të detajuar adresat e banesave ku ka jetuar me qira në periudha kohore të ndryshme, si vijon:

- Në harkun kohor nëntor 2014 - korrik 2015, subjekti ka deklaruar si adresë banimi “rruga ‘V.Z’”, p. ***, nr. **, ap. **, *Njësia Bashkiake nr. *, Tiranë*”, ku ka banuar së bashku me familjen e saj, dy prindërit, motra dhe gjyshja (e cila ka ndërruar jetë më 15.5.2015) në një apartament (2+1) të marrë me qira në vlerën 25.000 lekë/muaj.

Subjekti ka shpjeguar se nuk disponon dokument justifikues, pasi marrëveshja e qirasë është lidhur verbalisht midis prindërve të saj dhe shtetasës M.H, e cila administronte apartamentin e motrës së saj, znj. E.H (pronare e apartamentit).

- Në harkun kohor korrik 2015 - nëntor 2016, subjekti ka deklaruar si adresë banimi “Vlorë, Lagjja ‘P’, H.Xh (pallati përballë supermarket ‘D’, kati ***)”, për të cilën ka shpjeguar⁵⁸ se pas përfundimit të stazhit profesional

⁵⁵Shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2021.

⁵⁶Shkresë nr. *** prot., datë 9.4.2021.

⁵⁷Shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2021.

⁵⁸Në pyetësorin standard.

-
- të Shkollës së Magjistraturës (korrik 2015) ka filluar bashkëjetesën me z. F.K, i cili në këtë periudhë ushtronte funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ka banuar me të në një apartament të marrë me qira prej bashkëjetuesit, në vlerën 15.000 lekë/muaj. Sipas subjektit, kontrata e qirasë nga bashkëjetuesi është konkluduar verbalisht në mars të vitit 2015 dhe qiradhënës ka qenë z. D.H.
- Nga nëntori i vitit 2016 dhe në vijim, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi dhe adresë të regjistruar në gjendjen civile: “Rr e K, pallati P.C, Shkalla *, PBJ *, Apartamenti ***, kati *, Tiranë”, adresë e cila përkon me vendbanimin aktual të subjektit në apartamentin e marrë me qira (pasuria e trajtuar në pikën 1 më sipër) dhe përputhet me informacionin e ardhur nga Zyra e Gjendjes Civile⁵⁹.

75. Nisur nga fakti se për periudhën nëntor 2014 - korrik 2015 subjekti ka deklaruar se ka banuar së bashku me familjarët e saj, Komisioni verifikoi nëse prindërit e subjektit kanë krijuar pasuri të luajtshme apo të paluajtshme gjatë kësaj periudhe, duke kërkuar informacioni si vijon:

ASHK Korçë⁶⁰ ka informuar se shtetasi L.H ka pasur një apartament në pronësi të tij me nr. ***, e fituar me kontratë privatizimi datë 9.8.1993, e cila ka kaluar në pronësi të të tretëve me përmbarim në datën 29.7.2011.

DPSHTRR-ja⁶¹ ka konfirmuar se shtetasit L.H dhe S. H nuk kanë mjete në pronësinë e tyre.

ISSH-ja⁶² konfirmon se shtetasja S.H ka përfitur pension pleqërie nga muaji mars 2020.

QKB-ja⁶³ ka konfirmuar se shtetasi L.H rezulton të ketë qenë administrator me afat emërimi për periudhën 23.10.2008 – 23.10.2013 dhe është ortak me 18% të kuotave në shoqërinë “T.G” sh.p.k., me NIPT K***G, me objekt veprimtarie në fushën ndërtimore, bar-restorant, tregtim të artikujve të ndryshëm, etj.

76. Komisioni, gjithashtu, ka administruar në dosje informacion mbi llogaritë bankare të prindërve të subjektit dhe *statement* bankare⁶⁴ në vite të motrës së subjektit dhe nga verifikimi i tyre nuk u evidentua që familjarët e subjektit të kenë krijuar ndonjë depozitë apo të kenë kryer ndonjë transaksion të dyshimtë.

Llogaritë bankare janë llogari rrjedhëse ku janë kredituar pagat në punët respektive, si dhe kredi konsumatore në vlera të vogla të cilat janë paguar ndër vite.

⁵⁹Shkresë nr. *** prot., datë 29.3.2021.

⁶⁰Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2021.

⁶¹Shkresë nr. *** prot., datë 1.4.2021.

⁶²Shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2021.

⁶³Shkresë nr. *** prot., datë 2.4.2021.

⁶⁴Dërguar nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit datë 13.7.2022.

- ✓ Nga hetimi i kryer në lidhje me personat familjarë të subjektit, nuk u evidentuan problematika.

77. Komisioni verifikoi të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS⁶⁵ në lidhje me personat dhe automjetet me të cilët subjekti ka udhëtuar jashtë territorit të Shqipërisë, ku nga verifikimi i targave në sistemin e AMF-së nuk u evidentuan problematika. Shpenzimet e udhëtimit gjatë periudhës 2014 – 2016 janë reflektuar në analizën financiare të përgjithshme.

Analiza financiare për periudhën 2014 – 2016

78. Analiza financiare është kryer për të verifikuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga këto burime (në datën e krijimit të pasurisë). Analiza financiare u krye për periudhën 2014 – 2016 për të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë e subjektit, duke përfshirë edhe bashkëjetuesin nga muaji korrik 2015 e në vijim.

Tabela e përgjithshme e analizës financiare

| | <i>PASURITE deklaruar ne Vetting</i> | 2014 | 2015 | 2016 |
|------------|--|-----------------|------------------|------------------|
| Nr. | PASURI | -16 353 | -270 208 | 6 623 |
| 1 | <i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i> | <i>(16 353)</i> | <i>(270 208)</i> | <i>6 623</i> |
| 2 | Likuiditete Gjendje | (16 353) | (286 561) | (279 937) |
| | DETYRIME | - | 197 086 | (61 678) |
| 1 | Kontratë kredie bankare datë 25.09.2015 me RBAL 206,000 lekë | | 197 086 | (61 678) |
| | PASURI NETO = Pasuri - Detyrime | (16 353) | (467 294) | 68 301 |
| | TE ARDHURA | 737 336 | 1 793 781 | 2 326 156 |
| 1 | Te ardhura te subjektit | 737 336 | 1 015 671 | 957 418 |
| 2 | Te ardhura te b/shortit | - | 778 110 | 1 368 738 |
| | SHPENZIME | 300 077 | 866 530 | 1 395 614 |
| 1 | Shpenzime jetese | 219 998 | 336 414 | 470 184 |
| 2 | Shpenzime udhëtimi TIMS | 80 079 | 97 504 | 243 238 |
| 3 | Shpenzime mobilimi | | 127 500 | 158 162 |
| 4 | Shpenzime interesi dhe komisione kredi bankare | | 11 112 | 27 930 |
| 5 | Shpenzime qiraje | | 150 000 | 205 500 |
| 6 | Shpenzime te b/sh per promovim dhe botim te librit | | | 260 600 |
| 7 | Shpenzime te tjera | | 119 000 | |
| 8 | Shpenzime transporti | | 25 000 | 30 000 |
| | Rezultati= te ardhura - shpenzime - pasuri neto | 453 612 | 1 394 545 | 862 241 |

- ✓ Nga analiza financiare e kryer për periudhën 2014 – 2016, subjekti ka pasur burime të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet.

⁶⁵Me shpresën nr. *** prot., datë 31.3.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasuritë në deklaratën *Vetting* dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë. Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen së bashku me pasuritë e personit të lidhur, për një vlerësim sa më objektiv, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme të bashkëjetuesit për blerjen e automjetit, si një shkak i vetëm, nuk është i mjaftueshëm për të çuar subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

79. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

80. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjta gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar në krimin e organizuar.

81. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport⁶⁶ në përputhje me pikën 2, të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Ina Hoxhaj.

Vlerësimi i Komisionit për kontrollin e figurës

82. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga DSIK-ja në vitin 2017, për të cilin nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin e rivlerësimit Ina Hoxhaj.

83. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

84. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera

⁶⁶Raporti nr. *** prot., datë 26.10.2017, i deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

nuk rezultoi se: ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën; si dhe nuk ka bërë deklaratime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

85. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit⁶⁷ të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

86. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

i) Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit

Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar saktë, në përputhje me ligjin.

ii) Analizimi i dosjeve të përzgjedhura me short

Nga vëzhgimi i tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë i Gjyqësor, Komisioni ka evidentuar:

- tejkalim të afatit të arsytimit të vendimeve gjyqësore⁶⁸ për tri dosje (1, 2 dhe 3) përtej afateve të parashikuara ligj;
- tejkalim i afatit për gjykimin e çështjes për dosjen 4, e cila ka zgjatur gjithsej 5 muaj e 11 ditë nga afati standard 4-mujor i përcaktuar nga germa “d” e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit;
- Për dosjet 1 dhe 5 subjekti nuk ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës gjyqësore.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

⁶⁷Raporti nr. *** prot., datë 14.1.2022, i KLGJ-së.

⁶⁸Dosja 1 – vendimi gjyqësor është dorëzuar 14 ditë nga shpallja, duke shkelur afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale; dosja 2 – vendimi i arsyetuar është dorëzuar 12 ditë nga shpallja, në shkelje të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile; dosja 3 – vendimi i arsyetuar është dorëzuar 16 ditë nga shpallja, në shkelje të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile.

Me prapësimet e datës 13.10.2022, subjekti ka dhënë shpjegimet e saj për secilën nga konstatimet e Komisionit, si vijon:

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se vendimet gjyqësore për dosjet 1, 2 dhe 3 janë arsyetuar tej afatit të parashikuar në ligj, në një vonesë përkatësisht me 9 ditë, 2 ditë dhe 6 ditë, subjekti ka shpjeguar se për këto çështje i ka kushtuar rëndësi cilësisë së arsyetimit të vendimit, duke u nisur edhe nga diskutimet mbi ligjin dhe faktin që shtroreshin në to. Sipas shpjegimeve të subjektit, këto dosje i përkasin periudhës së stazhit profesional dhe praktikisht vitit të parë të punës si gjyqtare dhe të gjitha rastet kanë qenë precedente ku subjekti krijonte praktikën për herë të parë. Çështjet komplekse, sikurse janë dosjet e evidentuara prej Komisionit, kërkonin një angazhim më të madh në kohë dhe në studim me qëllim dhënien e një vendimi të arsyetuar sipas standardit të nenit 6 të KEDNJ-së, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me dosjen 4, ku çështja ka pasur si objekt zgjidhjen e martesës dhe gjykimi i saj ka zgjatur 5 muaj e 11 ditë, përtej afatit 4-mujor të përcaktuar në Aneksin e Sistemit të Vlerësimit, subjekti ka argumentuar se afatet e gjykimit të përcaktuara në ligjet procedurale apo aktet nënligjore, kur nuk janë afate të karakterit prekluziv apo afate dekadente, janë afate orientuese dhe disiplinore të cilat mund të tejkalohen për shkaqe objektive dhe të justifikuara nga rrethanat procedurale të shfaqura rast pas rasti. Për këtë dosje, gjykimi është zhvilluar me 8 seanca, disa nga të cilat kanë qenë joproduktive për shkak se ishte i pamundur njoftimi i palës së paditur, për rrjedhojë, afati i gjykimit është zgjatur për shkaqe të pavarura nga gjyqtari.

Sa i përket konstatimit të Komisionit se subjekti nuk ka zbardhur vendim për caktimin e seancës gjyqësore, subjekti ka argumentuar se këto lloj vendimesh janë vendime të ndërmjetme dhe ndaj të cilave nuk lejohet ankim i veçantë. Si të tilla, nuk parashikohet asnjë detyrim ligjor për t'u arsyetuar apo për t'u zbardhur. Në vijim, subjekti ka argumentuar se ligji procedural civil dhe penal vendos detyrime ligjore për të zbardhur apo arsyetuar vetëm vendimet e ndërmjetme ndaj të cilave lejohet ankim i veçantë në gjykatën më të lartë. Këto vendime, në ekstremitetet më të rëndësishme të të dhënave të tyre si caktimi i datës së seancës, identiteti i gjyqtarit dhe identifikimi i orës dhe vendit të seancës, dalin nga aktet e tjera procedurale të cilat janë pjesë e fashikullit të gjykimit.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse shkaqet, të cilat kanë çuar në zgjatje të afateve të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si dhe gjykimit tej afatit të caktuar. Nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla, që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

iii) Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Ina Hoxhaj nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.

Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Ina Hoxhaj, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Nga analizimi i pesë dosjeve të zgjedhura me short, sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë rezultuar si vijon:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara, subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme, jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret dhe kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor, duke zgjidhur saktësisht në themel mosmarrëveshjet objekt gjykimi.

Gjyqtarja Ina Hoxhaj ka manifestuar njohuri shumë të mira edhe në çështjet penale, duke i kushtuar mjaft rëndësi elementeve përbërëse të figurës së veprës penale (objekt, anë objektive, subjekt dhe anë subjektive), duke zgjidhur drejt në themel çështjet penale të gjykuara prej saj.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj ka aftësi shumë të mira dhe i kushton mjaft rëndësi arsyetimit ligjor në vendimet e dhëna prej saj, të cilat janë të arsyetuara, të qarta, të kuptueshme dhe qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar. Provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre, duke iu dhënë përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve të palëve. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton plotësisht standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Gjatë kohës së stazhit profesional të kryer pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në periudhën tetor 2014 – gusht 2015, subjekti ka përfunduar së gjykuari 156 çështje penale dhe civile, nga të cilat 20 janë çështje civile të përgjithshme + familjare, 114 janë çështje civile të veçanta, 19 janë kërkesa penale masa sigurimi dhe 3 janë penale themeli. Gjithashtu, në periudhën 23.6.2016 – 8.10.2016, kur subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, vetëm për 3 muaj ka marrë për gjykim

106 çështje civile dhe penale gjithsej, por për shkaqe të pavarura prej saj (nuk plotësohet një periudhë e plotë vjetore) nuk ka mundur të plotësojë standardin sasior të çështjeve të paracaktuar nga Sistemi i Vlerësimit.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Ina Hoxhaj ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë deri në 5 muaj e 11 ditë.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj është efiçente dhe efektive në çështjet që ka shqyrtuar.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga dosjet e vëzhguara, subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore, të cilat janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore/pajtimimit apo gjyqësore. Aftësi shumë të mira janë konstatuar edhe në gjykimet penale.

Asnjë seancë nuk ka dështuar për mangësi në organizimin e punës nga ana e gjyqtarës. Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga dosjet e vëzhguara, në tre prej tyre (dosjet 2, 3 dhe 4) nuk është konstatuar asnjë mangësi në aftësinë e gjyqtarës Ina Hoxhaj për të administruar dosjet dhe mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në këto dosje, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dy dosje të vëzhguara (dosjet 1 dhe 5) gjyqtarja Ina Hoxhaj nuk ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës gjyqësore. Aktet gjyqësore të ndodhura në dojet e vëzhguara janë të rregullta nga pikëpamja formale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Ina Hoxhaj. Në Inspektoratin e ish-KLD-së nuk rezultoi të ishte regjistruar asnjë ankesë për shkelje etike për gjyqtaren Ina Hoxhaj.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj, por edhe nga dosjet e vëzhguara, nuk evidentohen të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës Ina Hoxhaj nga gjykimi i çështjeve, gjithashtu, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në dosjet gjyqësore të vëzhguara është konstatuar se gjyqtarja Ina Hoxhaj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, ka aftësi komunikuese dhe shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës Ina Hoxhaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore. Nuk janë evidentuar vonesa në fillimin e seancave gjyqësore apo vonesa thelbësore në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj, në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 12 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se gjyqtarja ka shfaqur interes për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, të cilat i kanë shërbyer për të plotësuar mësëmiri formimin e saj profesional dhe etik.

Pranë Komisionit nuk është depozituar ndonjë denoncim për gjyqtaren Ina Hoxhaj.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e gjyqtarës Ina Hoxhaj dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ina Hoxhaj ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e saj, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ina Hoxhaj, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.10.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Etleda ÇIFTJA

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Dajana Skura

